

KËRKESË PËR LICENSE PËR VEPRIMTARI ME GJENERATORË ME RREZE X
/ LLAMBË ME RREZE X

IMPORT/EKSPORT

-Personi juridik/ fizik:

Emri, Mbiemri(përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Tel _____
E-mail _____
Ekstrakti i rregjistrimit në QKB _____

Dokumente për tu ngarkuar në sistem sipas renditjes

1. Dokumenti me llojet e pajisjeve që do të importohen/eksportohen sipas funksionit (ct skaner, radiografi, grafi, panorameks, mamografi, densitometër, koronografi etj), si dhe të sqarohet nëse do importohen/eksportohen llamba me rreze x.
2. Rregullore e brendshme mbi menaxhimin e import/eksportit të gjeneratorëve dhe llambave me rreze x sipas sqarimit në pikën nr.1
3. Dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit sipas sqarimit në pikën nr. 2

Duke mbajtur përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format PDF me ngjyra .

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licencë. Bazuar në nenin 3 të rregullores të miratuar me vendimin nr.10 datë 7.01.2010 ,të Këshillit të Ministrave ,Për miratimin e rregullores “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese “, për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik aplikon jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Procedurave Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga paraqitja e plotë e dokumentacionit.

Shënim :

1.Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me ligjin nr.8025, datë 09.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese “,të ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.

2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet , Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë

Gjeneratorë/llambë me rreze x

Import/eksport

Pika 1-Të paraqitet një rregullore e brendshme e subjektit. Në rregullore të përcaktohet qartë që subjekti nuk transferon pajisje me rreze x ose llampë me rreze X në subjekte të cilat nuk disponojnë licencën përkatëse. Të përcaktohet qartë adresa e magazinimit të pajisjeve dhe llambave me rreze X të importuara.

Pika 2- Paraqit me shkrim mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit për të gjitha pajisjet dhe llambat me rreze X,që importohen/eksportohen, listën e të gjithë subjekteve ku do të transferohen, lejet e import/eksportit të lëshuara nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, certifikatën e cilësisë së gjeneratorit me rreze X.